



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

Nr. _____ Prot .

Datë 26.06.2009

V E N D I M

Nr. 119 Datë 26 .06. 2009

“Mbi

Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100 % të aksioneve të Bankës së Kreditit të Shqipërisë nga shoqëria Anika Enterprises SA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Z. Koço Broka Anëtar
- Znj. Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.06.2009, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes 100 % të aksioneve të Bankës së Kreditit të Shqipërisë nga shoqëria Anika Enterprises SA

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Transaksioni me anë të të cilit synohet përfundimi i plotë i kontrollit nëpërmjet transferimit 100% të kapitalin aksionar me të drejtë vote të shoqërisë Banka e Kreditit të Shqipërisë në shoqërinë Anika Enterprises SA, realizohet në bazë të

marrëveshjes për blerje aksionesh, e nënshkruar ndërmjet palëve më datë 6 Mars 2009 dhe është njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës më datë 11 Mars 2009, brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 12, pika 2 e Ligjit.

Vlera e transaksionit është 30 milion dollarë amerikanë(USD) dhe do të shlyhet nga blerësi me burimet e veta financiare, sipas modaliteteve të përcaktuara në nenin 3 të marrëveshjes⁽¹⁾.

Ky transaksion, nëpërmjet të cilit realizohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë përfitimi i kontrollit, sjell ndryshime mbi një bazë të qëndrueshme të kontrollit, në kuptim të nenit 10, pika 1 dhe 2 dhe konsiderohet përqendrim.

II. Palët në transaksion

Banka e Kreditit të Shqipërisë Sha (CBA) në cilësinë e shitësit, është një shoqëri e krijuar dhe që funksionon sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me vendimin Nr. 27845, datë 03.06.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën: rruga “Perlat Rexhepi”, Tiranë.

CBA kryen veprimtari bankare dhe financiare në tregun bankar brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duke ofruar shërbime/ produkte të përcaktuara në licensën Nr 15 datë 28.08.2002 “Për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”.

Banka e Kredit të Shqipërisë është pjesë e grupit M.A AL Kharafi & Sons W.LL⁽²⁾.

Anika Enterprises SA, në cilësinë e blerësit, është një shoqëri e krijuar dhe që funksionon sipas legjislacionit zviceran, me seli në “Rue Saint-Laurent 15-17, 1207”, Gjenevë, Zvicër, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shoqërive në Gjenevë, datë 28.9.2004, e përfaqësuar nga Z. Rezart Taçi, i cili është dhe zotërues i 100% të kapitalit të shoqërisë. Objekti i shoqërisë është tregtimi i produkteve të ndryshme, kryesisht karburante dhe nënprodukte të tij. Shoqëria operon kryesisht në tregun zvicerian por dhe në tregje të tjera ndërkombëtare.

Shoqëria Anika Enterprises SA është aksioner dhe zotëron 70% të aksioneve të shoqërisë së përbashkët AMRA OIL SH.A⁽³⁾.

III. Xhiro e ndërmarrjeve

¹ Marrëveshja për shitjen e aksioneve, fq 8, pika 3

² Rasti Mak Albania shqyrtuar nga Komisioni i Konkurrencës në Janar 2009

³ Vendimi i Komisionit të Konkurrencës Nr 91, datë 26.10.2008 Rasti ARMO/AMRA

Referuar balanceve të shoqërive⁽⁴⁾ të përfshira në transaksionin e shitblerjes rezulton se:

A. Xhiro totale e realizuar në tregun ndërkombëtar për vitin 2007, është rreth xxx miliardë Lekë > xxx Miliardë⁽⁵⁾, e ndarë:

- Xhiro e realizuar nga Banka e Kreditit të Shqipërisë është: xxx Miliardë lekë⁽⁶⁾.
- Xhiro e realizuar nga Anika Enterprises SA është rreth xxx miliardë lekë

B. Xhiro totale e realizuar në tregun e brendshëm është : xxx Miliardë lekë ⁽⁷⁾ e ndarë:

- Xhiro e realizuar nga Banka e Kreditit të Shqipërisë është: xxxx lekë;
- Xhiro totale e realizuar nga ndërmarrjet e zotëruara nga i njëjti person fizik është xxx lekë, (respektivisht Taçi Oil xxx lekë dhe Kuid Shpk xxx lekë).

Sa më lart, ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqëndrim përmbushin kriteret kumulative të xhiros në tregun e brendshëm në kuptim të nenit 12, pika 1 gërma a e Ligjit.

IV. Tregu Përkatës:

a. Tregu i produktit:

Palët pjesëmarrëse ushtrojnë veprimtari në tregje të ndryshme të produktit si vijon:

I) Anika Enterprises SA dhe të gjitha shoqëritë filiale të saj⁽⁸⁾, ushtrojnë veprimtarinë në tregun e prodhimit dhe tregtimit të produktit të naftës dhe të nënprodukteve të saj, përfshirë edhe eksport-importin e karburanteve dhe nënprodukteve të tyre

II) Banka e Kreditit të Shqipërisë ushtron veprimtari në tregun bankar brenda territorit të Shqipërisë, e licensuar për ofrimin e shërbimeve të një banke tregtare, kryesisht në: pranimin dhe grumbullimin e depozitave bankare, dhënien e kredive, marrje hua, shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve etj

⁴ Shkresa Nr 123/1 Bilanci i CBA dhe Bilanci Anika Enterprises SA

⁵ Kufiri i përcaktuar në nenin 12 pika 1 shkronja a) e Ligjit 9121 “Per mbrojtjen e konkurrences”

⁶ Llogaritja e e xhiros për CBA është bërë në bazë të nenit 16 të Ligjit. Rasti Mak Albania/ M.A AL Kharafi & Sons W.LL . - Struktura e grupit dhe xhiro ndërkombëtare e grupit 215.600.684 Dinarë Kuvaitianë. Kursi i këmbimit www.xe.com- 1KWD=352 lekë .

⁷ Njoftim i Konsoliduar i komisionit, par 151 *Acquisitions of control by natural persons*

⁸ Neni 16, pika 1, shkronja b e Ligjit.....në të cilat ndërmarrja pjesëmarrëse, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, zotëron më shumë se gjysmën e kapitalit ose më shumë se gjysmën e votave, ose ka fuqinë të emërojë më shumë se gjysmën e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, të këshillit administrativ ose të strukturave të tjera ligjore, që përfaqësojnë ndërmarrjen, ose ka të drejtë të drejtojë çështjet e ndërmarrjes.

Për analizën e konkurrencës dhe vlerësimin e këtij përqendrimi, meqënëse ndërmarrja objekt transaksioni është Banka e Kreditit të Shqipërisë, si treg përkatës të produktit do të konsiderojmë ofrimin e shërbimeve bankare.

Në tregun e produktit pjesa që zotëron Banka e Kreditit të Shqipërisë (CBA) është relativisht shumë e vogël, ndërsa filialet e grupit Al-Kharafi ushtrojnë veprimtari në fushën e transportit ajror të pasagjerëve, në ndërtim, hoteleri etj.

b. Tregu gjeografik:

Për vlerësimin e këtij përqendrimi dhe efektet që sjell në treg, treg gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

V. Analiza e konkurrencës

Transaksioni i shitblerjes së aksioneve të Bankës së Kreditit të Shqipërisë nuk ndryshon strukturën e tregut bankar. Banka e Kreditit të Shqipërisë bën pjesë në grupin e bankave G 1, me kapital nën 2%.

Ky ndryshim lidhet vetëm me ndryshimin e aksionerëve të bankës dhe në kuptim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” është përfitim i plotë i kontrollit të Bankës së Kreditit nga shoqëria “Anika Enterprises SA”.

Palët pjesëmarrëse kanë pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë në disa shoqëri që ushtrojnë veprimtari në tregje të ndryshme nga tregu bankar dhe nuk kanë klientë të përbashkët.

Në bazë të përkufizimit të tregjeve të prekura, sipas seksionin 6(III) të “Formularit të njoftimit të përqëndrimit” dhe bazuar në analizat ekonomike, nuk ka tregje të prekura nga përqëndrimi i njoftuar.

Sa më lart, transaksioni i njoftuar që konsiston në përfitim të kontrollit të plotë të Bankës së Kreditit të Shqipërisë nga shoqëria Anika Enterprises SA, nuk ndryshon strukturën e tregut bankar dhe nuk krijon ose forcon pozitën dominuese të shoqërisë pas përqëndrimit në kuptim të nenit 56, pika 1 e Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100 % të aksioneve të Bankës së Kreditit të Shqipërisë nga shoqëria Anika Enterprises SA.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve .

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)

Anëtar

Lindita MILO (LATI)

KRYETARE